REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE
NR 30180

VENDIM

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 08.05.03 une M. Luma Gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Teuta Resuli /Luarasi/, Ortak e Administrator I vetem i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, i cili kerkon te Regjistroje si person juridike shoqerine me pergjegjesi te kufizuar"Shtypshkronja Teuta" SHPK dhe

KONSTATOVA

Se kerkuesi , kerkon te Regjistroje si person juridik shoqerine "Shtypshkronja Teuta",SHPK me Ortak e Administrator I vetem I shoqerise Teuta Resuli /Luarasi/,me kohezgjatje mbi 10 vjet,me Seli ne Durres,Rruga "Dalip Peza"me kapital themelor prej 100.000 Leke te reja , dhe me objekt veprimtarie

1.Botim,shtypje dhe shperndarje te librave dhe shtypshkrime te te gjitha llojeve
2.Prodhim dhe shitje artikuj shkollore dhe kancelari te ndryshme
3.Prodhim qese dhe kuti ambalazhi te llojeve te ndryshme
4.Shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshem industriale

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

PER KETE ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 dt 19.11.1992 per shoqerite tregetare si dhe ligjit 7667 dt 28.01.1993 Per regjistrin tregetar

**VE N D O S A**

Regjistrimin si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "**Shtypshkronja Teuta" SH.P.K**. me **Ortak e Administratori te vetem Teuta Resuli (Luarasi)** ,me kohezgjatje mbi 10 vjet,me kapital themeltar 100.000 /njeqindmije leke/,me Seli ne Rruga "Dalip Peza",Durres, me objekt veprimtarie

1.Botim,shtypje dhe shperndarje te librave dhe shtypshkrime te te gjitha llojeve
2.Prodhim dhe shitje artikuj shkollore dhe kancelari te ndryshme
3.Prodhim qese dhe kuti ambalazhi te llojeve te ndryshme
4.Shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshem industriale

Kunder ketij vendimi lejohet ankim

**GJYQTARE**

M. Luma

**Nr** **Rregjistrimi .** 30180

## URDHER RREGJISTRIMI

Emri : "Alogpsikologji Teuta" shpk.

Selia : Rr "Dalip Zeka" Durrës

Objekti: Zbatime, mirëmbajtje e librave etj, prodhim e shitje e artikujve shkollorë, prodhime ambalazhi, shitje e materialeve ind-

Kapitali : 100.000 lekë

Ortaket : Teuta Reneli 100%

Administrator: T. Reseli

Kohezgjatja : mbi 10 vjet

Statuti : 67

Akti i Themelimit : 37

Data e nenshkrimit te Statutit : 05-08-03

Data e Rregjistrimit ; 08-08-03

**Shenime** - Vërtetuar me noterial Nr 4633 dt. 05-08-03 i noterit D. Pepi, Tiranë

**GJYQTARE**

**BLERINA MUÇA**

# AKT THEMELIMI
# I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# SHTYPSHKRONJA "TEUTA"

Me anen e ketij akti themelimi , une ortakja e vetme e shoqerise SHTYPSHKRONJA "TEUTA"

**TEUTA RESULI (LUARASI),e bija e Selimit,lindur me 16.08.1958 dhe banuese ne Durres,Lagja 6,Rr.'M.Muco' nr.194 , Durres ,identifikuar me pasaporten nr. 0585653.**

## V E N D O S A

Te themeloj Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar , emertimi I plote I te ciles eshte SHTYPSHKRONJA "TEUTA"

## NENI 1
## SELIA E SHOQERISE

Selia e SHOQERISE do te jete ne qytetin e Durresit , lagja 17 ,rruga "Dalip Peza ".

## NENI 2
## OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti I veprimtarise se SHOQERISE eshte :

1. **Botim ,shtypje dhe shperndarje te librave dhe shtypshkrime te te gjitha llojeve .**
2. **Prodhim dhe shitje artikuj shkollor dhe kanceleri te ndryshme .**
3. **Prodhim qese dhe kuti ambalazhi te llojeve te ndryshme.**
4. **Shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale.**

## NENI 3
## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e SHOQERISE eshte caktuar mbi 10 vjet.
Me vendim te ORTAKUT TE VETEM te SHOQERISE, kohezgjatja e SHOQERISE mund te caktohet pertej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm.

## NENI 4
## PERSONALITETI JURIDIK

**SHOQERIA** fiton personalitetin juridik ne diten e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes, ndersa veprimtaria tregtare e saj fillon me rregjistrimin ne organet tatimore.

## NENI 5
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar I SHOQERISE eshte 100.000 (njeqintemije)leke.
E gjithe pjesa e kapitalit themeltar eshte nenshkruar ne teresine e saj nga Ortaku themelues.
Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre.
Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themelor te SHOQERISE behet me vendim te ORTAKUT te vetem .
Transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial.

## NENI 6
## ADMINISTRIMI

**SHOQERIA** administrohet nga **ADMINISTRATORI i** saj, z .Teuta Resuli(Luarasi) i cili eshte njekohesisht edhe ortaku I vetem i kesaj shoqerie ,i cili perfaqeson **SHOQERINE** ne mardhenie me te tretet.

**ORTAKU i vetem i SHOQERISE** mund ti delegoje kopetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
Vendimet e **ORTAKUT** evidentohen ne nje regjister te vecante.

## NENI 7
## SHNDERRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA mund te shnderrohet ne nje shoqeri kolektive , komandite , anonime me vendim te ORTAKUT dhe ne perputhje me Legjislacionin Tregtar Shqiptar .

**NENI 8**
**PRISHJA E SHOQERISE**

**SHOQERIA** prishet ne rastet kur

a. mbaron afati I parashikuar ne Aktin e Themelimit .
b. nuk mund te realizohet objekti I **SHOQERISE** sipas kontrates themelimit dhe Statutit .
c. nje vendim te tille e merr **ORTAKU i vetem i SHOQERISE .**

**NENI 9**
**HYRJA NE FUQI**

Kjo kontrate themelimi hyn ne fuqi diten e nenshkrimit te tij perpara noterit

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË SHTYPSHKRONJA "TEUTA"**

**TEUTA RESULI (LUARASI)**

Teuta Resuli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 4631 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 05.09.2003,para meje Notere Drita Pepi me Adrese ne Bulevardi "Zhan D'Ark",prane Gjykates se Shkalles se Pare,Tirane u paraqit personalisht Shtetesi Teuta Resuli /Luarasi/, I datelindjes 16.08.1958,me banim Durres,madhore, me zotesi juridike per te vepruar, e njohur prej meje, dhe deklaroi se Akti, redaktuar jashte kesaj zyre,eshte sipas vullnetit te saj dhe e ka nenshkruar ,une noterja vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

N O T E R E
DRITA PEPI

STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

SHTYPSHKRONJA "TEUTA"

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar SHTYPSHKRONJA "TEUTA'e cila ketu me poshte quhet 'Shoqeria ')eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit ,nga ortaku :

**TEUTA RESULI (LUARASI),e bija e Selimit,lindur me 16.08.1958 dhe banuese ne Durres,Lagja 6,Rr.'M.Muco' nr.194 , Durres ,identifikuar me pasaporten nr. 0585653.**

Kjo **SHOQERI** ne perputhje me legjislacionin shqiptar e vecanerisht me Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 'Per shoqerine tregtare ' krijohet nga **ORTAKU** I vetem i kesaj **SHOQERIE** per te ushtruar veprimtari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit apo nga ky STATUT .

NENI 1

EMERTIMI

SHOQERIA emertohet SHTYPSHKRONJA "TEUTA"

SHOQERIA eshte person juridik I se drejtes shqiptare dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te ketij **STATUTI** .

**SHOQERIA** do te quhet person juridik dhe do te veproje si e tille duke filluar nga dita e rregjistrimit te saj ne gjykate , ndersa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin e saj ne organet tatimore .

NENI 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti I veprimtarise se **SHOQERISE** eshte

1. **Botim ,shtypje dhe shperndarje te librave dhe shtypshkrime te te gjitha llojeve .**
2. **Prodhim dhe shitje artikuj shkollor dhe kanceleri te ndryshme .**
3. **Prodhim qese dhe kuti ambalazhi te llojeve te ndryshme.**
4. **Shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale.**

## NENI 3

## QENDRA E SHOQERISE

Qendra e **SHOQERISE** ndodhet ne qytetin e Durresit , lagja 17 ,rruga ''Dalip Peza ''.
**SHOQERIA** me vendim te organeve te saj kopetente , rast pas rasti , do te krijoj transferoje dhe/ose anulloj seli dytesore . seli administrative . drejtori . filiale , dege , agjensi dhe zyra si ne teritorin shqiptar ashtu edhe jashte vendit .

## NENI 4 .

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar mbi 10 vjet .

Me vendim te **ORTAKUT te vetem** kohezgjatja e **SHOQERISE** mund te caktohet tej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperm .

## NENI 5

## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar I **SHOQERISE** eshte 100.000 leke (njeqintemije).
E gjithe pjesa e kapitalit themeltar eshte nenshkruar ne teresine e saj nga Ortaku themelues .
Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre .

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themelor te SHOQERISE behet me vendim te **ORTAKUT TE VETEM** .

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te **SHOQERISE** ne te gjitha Bankat qe ndodhen ne teritorin e Shqiperise .

Transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt noterial .

## NENI 6

## VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare te **SHOQERISE** pasqyrohen ne llogarite(kontabilitetin )e saj , duke aplikuar kriteret e dispozitat mbi kontabilitetin e shoqerive tregtare te parashikuara nga legjislacioni shqiptar .

## NENI 7

## BLERJET E SHOQERISE

**SHOQERIA** disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj .
**SHOQERIA** ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve .

## NENI 8

## BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

**SHOQERIA** per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e saj . Perberja . madhesia e tyre , burimet e krijimit , perdorimi e rregullimi I cdo fondi te vecante vendoset nga **ORTAKU i VETEM i** saj ,duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi .

**SHOQERIA** disponon mjetet e saj financiare . Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se **SHOQERISE** do te mbulohen nga fondet perkatese apo fondet rezerve ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar .

Te gjitha pasurite e **SHOQERISE** pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare .

Bilanci dhe llogarite e **SHOQERISE** perpilohen e mbahen nga Administratori .

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

**NENI 9**

**ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**SHOQERIA** administrohet nga **ADMINISTRATORI i** saj , zj.Teuta Resuli ( Luarasi ) i cili eshte njekohesisht edhe Ortaku i vetem i kesaj shoqerie ,i cili perfaqeson **SHOQERINE** ne mardhenie me te tretet .
**ORTAKU I SHOQERISE** mund ti delegoje kopetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure .
Vendimet e **ORTAKUT** te vetem evidentohen ne nje regjister te vecante .

**NENI 10**

**ORTAKU I SHOQERISE**

**ORTAKU I SHOQERISE** ushtron te gjitha kopetencat , te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e **SHOQERISE** te parashikuara nga ky statut , Akti I Themelimit si dhe nga legjislacioni tregtar shqiptar .
Ai ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet qe I konsideron te domosdoshme per realizimin e qellimeve te **SHOQERISE** , pa cenuar interesat e tij.

**NENI 11**

**ORTAKU i vetem** i cili eshte njekohesisht edhe administratori i **SHOQERISE** pergjigjet per te gjithe veprimtarine e **SHOQERISE** qe nga momenti I themelimit te saj .

## NENI 12

## MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ndermjet **SHOQERISE** , filialeve e agjensive te saj (nese krijohen te tilla )dhe punonjesve te saj rregullohen me kontraten e punes . Per ceshtje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar .

## NENI 13

## NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne **STATUT** mund te behen me vendim te **ORTAKUT te vetem** dhe sipas dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin ' Per Shoqerite Tregtare '.

## NENI 14

## SHNDERRIMI I SHOQERISE

**SHOQERIA** mund te shnderrohet ne nje shoqeri kolektive , komandite apo anonime me vendim te **ORTAKUT** te saj .
Shnderrimi I **SHOQERISE** ne nje shoqeri tjeter do te konsiderohet I vlefshem vetem duke respektuar dispozitat ligjore te parashikuara nga ligji ' Per Shoqerite Tregtare '.

## NENI 15

## PRISHJA E SHOQERISE

**SHOQERIA** prishet ne rastet kur

a. mbaron afati I parashikuar ne Aktin e Themelimit .
b. nuk mund te realizohet objekti I **SHOQERISE** sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit .
c. nje vendim te tille e merr **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE .**

## NENI 16

## LIKUJDIMI I SHOQERISE

Likujdimi I **SHOQERISE** do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne castin e likujdimit .
**ORTAKU** I vetem vendos rregullat per proceduren e likujdimit si dhe per personat qe do ti aplikojne ato .

## NENI 17

## DISPOZITE E FUNDIT

Ky **STATUT** hyn ne fuqi diten e rregjistrimit te **SHOQERISE** ne Gjykaten e Rrethit Tirane .
Ky **STATUT** u njoh dhe u nenshkrua nga **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE** ne Tirane me 05.09.2003

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË SHTYPSHKRONJA "TEUTA"**
**TEUTA RESULI (LUARASI)**

Teuta Resuli

POLLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 0630 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 05.09.2003,para meje Notere Drita Pepi me Adrese ne Bulevardi "Zhan D'Ark",prane Gjykates se Shkalles se Pare,Tirane u paraqit personalisht Shtetesi Teuta Resuli /Luarasi/, I datelindjes 16.08.1958,me banim Durres,madhore, me zotesi juridike per te vepruar, e njohur prej meje, dhe deklaroi se Statuti, redaktuar jashte kesaj zyre,eshte sipas vullnetit te saj dhe e ka nenshkruar ,une noterja vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

N O T E R E
DRITA PEPI

3018?

08 Shtator 2003 — 08 09 2003

KERKESE

KERKUESI Teuta Selim Resuli/Luarasi/, I datelindjes 16.08.1958, me banim Durres

OBJEKTI Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " **Shtypshkronja Teuta** "

BAZA LIGJORE Ligji 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Une kerkuesi, Teuta Resuli/Luarasi/,kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Shtypshkronja Teuta" SHPK,me kohezgjatje mbi 10 vjet,me Seli ne Qytetin e Durresit,Rruga "Dalip Peza",me kapital themelor prej 100.000 /njeqind mije/ leke,me objekt veprimtarie

1. Botim,shtypje dhe shperndarje te librave dhe shtypshkrime te te gjitha llojeve
2. Prodhim dhe shitje artikuj shkollore dhe kancelari te ndryshme
3. Prodhim qese dhe kuti ambalazhi te llojeve te ndryshme
4. Shitje me shumice e pakice te mallrave te ndryshem industriale

KERKUESI
TEUTA RESULI /LUARASI/

04.08.03

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 4629 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 05.09.2003,para meje Notere Drita Pepi me Adrese ne Bulevardi "Zhan D'Ark",prane Gjykates se Shkalles se Pare,Tirane u paraqit personalisht Shtetesi Teuta Resuli/Luarasi/,I datelindjes 16.08.1958,me banim Durres ,madhore, me zotesi juridike per te vepruar,e njohur prej meje dhe deklaroi se nenshkrimi ne Kerkese redaktuar jashte kesaj zyre,eshte ne vullnetin e saj dhe nenshkrimi eshte I saj ,une noterja vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

NOTERE
DRITA PEPI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 4633 Regj

VERTETIM

Ne Tirane ,sot me dt 05.09.2003,u paraqit para meje Notere Drita Pepi,me Adrese Bulevardi Zhan D'Ark,prane Gjykates se Shkalles se Pare

SHTETESI Teuta Resuli (Luarasi), e datelindjes 16.08.1958,me banim Durres , madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar,e njohur personalisht prej meje, dhe depozitoi prane kesaj Zyre Noterie,shumen prej 100.000/njeqind mije leke/,te shoqerise ne krijim e siper "Shtypshkronja Teuta" Sh.p.k

Me marjen e Vendimit nga Gjykata,per regjistrimin e SH.P.K."Shtypshkronja Teuta", kete shume e terheq.

TEUTA RESULI ( LUARASI)

Teuta Resuli

NOTERE
DRITA PEPI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJITIKËS
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

# ÇERTIFIKATË E KRYERJES SË REGJISTRIMEVE TË TJERA

Qendra Kombëtare e Regjistrimit vërteton se me date **06.12.2007** është kryer regjistrimi i aplikimit:

regjistrime te tjera
specifikoni llojin e ndryshimit)

**Per emerimin e Fatmir Turkeshit, ekspertit kontabel te autorizuar me nr 93 license per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise Teuta Print shpk,**
**Ndryshimin e emertimit te shoqerise Shtypshkronja Teuta ne emrin e ri Teuta Print shpk**

Paraqitur nga **Teuta Luarasi**

me numër çështje **CN – 104994-11-07**

Data e leshmit
**06.12.2007**

Sporteli i sherbimit
**Brunilda Cato**

______________________

Emri, Mbiemri, Nenshkrimi
(i nepunesit te sportelit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJITIKËS
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

# ÇERTIFIKATË E KRYERJES SË REGJISTRIMEVE TË TJERA

Qendra Kombëtare e Regjistrimit vërteton se me date **07.12.2007** është kryer regjistrimi i aplikimit:

regjistrime te tjera
specifikoni llojin e ndryshimit)

**Per miratimin e raportit per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise Teuta Print shpk, te paraqitur nga eksperti kontabel Fatmir Turkeshi.**
**Pas zmadhimit kapitali themeltar I shoqerise Teuta Print shpk eshte 1.870.000 leke.**

Paraqitur nga **Teuta Luarasi**

me numër çështje **CN – 104994-11-07**

Data e leshmit
**07.12.2007**

Sporteli i sherbimit
**Brunilda Cato**

____________________

Emri, Mbiemri, Nenshkrimi
(i nepunesit te sportelit)